

**RAPORT I STAVRO SKËNDIT DREJTUAR OSS* NË WASHINGTON,
D.C. “SHQIPËRIA NËN PUSHTIMIN GJERMAN”, STAMBOLL,
12 PRILL 1944¹**

I. Pushtimi gjerman

1. Ushtritë gjermane hynë në Shqipëri në periudhën gusht-shtator 1943, në dy drejtime të ndryshme. Njëra erdhi nga Greqia dhe pushtoi Shqipërinë Jugore. Kjo e fundit, ishte urdhëruar ta konsideronte popullsinë [vendase] si armike, dhe të merrte masa të ashpra kundër saj, sepse kjo pjesë e vendit ishte mbushur me banda guerile dhe kishte bërë rezistencë të fortë kundër pushtuesit. Trupat [gjermane] dogjën fshatra, vranë shumë njerëz dhe terrorizuan pjesën tjetër. Prefektura e Korçës pati fatin më të keq.
2. Ushtria e dytë erdhi nga Jugosllavia dhe pushtoi Shqipërinë Veriore dhe Qendrore. Ajo ishte urdhëruar që ta trajtonte popullsinë me butësi, me sa duket, sepse në këtë pjesë të Shqipërisë rezistenca kishte qenë pak aktive, dhe se gjermanët e ndjenin që kosovarët i konsideronin këta të fundit si çlirimtarë nga zgjedha jugosllave. Kështu, gjermanët që nga fillimi i pushtimit të tyre shfaqën dy karakteristika të politikës së tyre, ashpërsinë dhe butësinë.

II. Dy organizatat revolucionare shqiptare: Nacionalçlirimtarja dhe Balli Kombëtar

1. Trupat gjermane, si ato që erdhën nga Greqia, ashtu edhe ato që erdhën nga Jugosllavia, u sulmuan nga të dyja organizatat shqiptare të rezistencës: Nacionalçlirimtarja dhe Balli Kombëtar. Këto dy grupe kishin ardhur në jetë gjatë sundimit italian. Grupi i parë, ku Partia Komuniste përbënte bërthamën, ishte e përbërë kryesisht nga të rinj plot me entuziazëm dhe shpirt sakrificë, agresivë dhe të etur për veprim. Grupi i dytë ishte i përbërë kryesisht nga më të vjetër, të cilët ishin të matur në veprimet e tyre, dhe që kërkonin një organizim më të mirë, për të paraqitur forcat e tyre, duke pritur “momentin e duhur” për veprim.
2. Të dyja organizatat kishin si qëllim primar çlirimin e vendit nga pushtuesi. Pas tyre qëndronte i tërë populli shqiptar, dhe në të vërtetë, po qe se Aleatët do të zbarkonin në Shqipëri gjatë ditëve të para të zbarkimit të tyre në Itali, do të kishin ndodhur jo vetëm luftë gueriljesh, siç po ndodh aktualisht, por një revoltë e përgjithshme.

* Office of Strategic Services (OSS) – Zyra e Shërbimeve Strategjike.

¹ *National Archives and Record Administration, Washington, DC (NARA), OSS, RG 226, nr. 75906.*

III. Politika gjermane në Shqipëri

1. Gjermanët pasi përfunduan pushtimin e Shqipërisë pas kapitullimit të italianëve, deklaruan se pushtimi i tyre ishte vetëm ushtarak, dhe se ata do t'i linin shqiptarët të lirë që të qeverisnin vendin e tyre. Ata formuan menjëherë një të ashtuquajtur "Komitet Kombëtar", nën drejtimin e Ibrahim Biçakut dhe garantuan lirinë e fjalës dhe të shtypit. Asnjëherë deri në atë kohë Shqipëria nuk kishte gëzuar një liri të tillë, se sa ajo e periudhës së këtij Komiteti nën pushtimin gjerman. Qëllimi i kësaj lirie ishte i qartë. Gjermanët nga njëra anë donin të fitonin simpartinë e shqiptarëve, nëpërmjet kontrastit me [periudhën] e pushtimit fashist italian, ndërsa nga ana tjetër, ata donin të inkurajonin shfaqjen e korrenteve të ndryshme politike dhe grupimeve rivale, me qëllim që të kuptonin më mirë situatën, dhe t'i vinin ato kundër njeri-tjetrit. Kjo do të lehtësonte sundimin e tyre.
2. Gjithashtu, gjermanët njohën pavarësinë dhe neutralitetin e Shqipërisë dhe ishin në gjendje të krijonin një Asamble të Përgjithshme (e ndryshuar më vonë në Parlament); një Këshill Regjence (i emërtuar Këshilli Suprem në Shqipëri), në të cilën morën pjesë disa nga patriotët më të njohur si: Mehdi Frashëri, Fuad Dibra (derisa vdiq), Lef Nosi dhe Patër Anton Harapi. Ndërkaq, ata nuk e penguan Mehdi Frashërin, kryetarin e Këshillit të Regjencës që të protestonte tek qeveria gjermane kundër pushtimit të Shqipërisë nga ushtritë gjermane, si dhe që të dërgonte telegrame tek drejtuesit e Fuqive të Mëdha për neutralitetin e saj [Shqipërisë], tek Hitleri dhe tek drejtuesit e shteteve neutrale të Evropës. Megjithatë, ata [gjermanët] e bënë të qartë se do ishin mizorë kundër atyre që do të sulmonin ushtarët gjermanë.

IV. Ndryshimi i qëndrimit të Ballit Kombëtar

1. Lëshimet e gjermanëve tërhoqën nacionalistët brenda dhe jashtë Ballit Kombëtar, të cilët e konsideruan meçuri ndalimin e rezistencës aktive kundër gjermanëve. Për më tepër, nacionalistët mendonin se ekzistonin shumë disavantazhe po të luftonin kundër gjermanëve. Vendi ishte përballur me shkatërrime të mëdha gjatë 5 viteve të rezistencës; krahina të tëra ishin shkretuar nga trupat pushtuese dhe mijëra njerëz ishin larguar në male pa ushqim dhe strehim, ndërsa dimri i zymtë po afrohej. Siç e bënte të qartë një oficer britanik në Shqipëri, një e treta e pjesës jugore të vendit ishte djegur nga italianët, një e treta nga gjermanët dhe vetëm një e treta i kishte shpëtuar rrënimit.
2. Nacionalistët gjithashtu ishin të shqetësuar në lidhje me kufijtë. Grekët kishin dhënë prova të mjaftueshme se lakmonin Shqipërinë e Jugut, ndërsa

përleshjet ndërmjet çetnikëve serbë dhe kosovarëve kishin shtuar frikën e një përplasjeje të ardhshme e cila duhej parandaluar.

3. Veç këtyre, bandat nacionaliste në male ishin shumë të dobta për t'u përballur me operacionet ushtarake gjermane. Këto kishin dhënë prova të mungesës së organizimit. Për më tepër, ndihma e aleatëve kishte qenë shumë e kufizuar dhe nuk kishte ndonjë shpresë për zbarkimin e shpejtë të tyre [në Shqipëri]. Megjithëkëtë, bandat e Ballit Kombëtar vazhduan të mbeteshin në male deri në nëntor 1943, ndonëse mbetën inaktive kundër gjermanëve. U vu re një çarje që ndodhi ndërmjet atyre që ishin në male dhe atyre që morën pjesë në Qeveri. Por kjo nuk zgjati shumë. Sot, në tërësi Balli Kombëtar mbështet qeverinë dhe gjendet në konflikt të hapur me komunistët, përhapja e të cilëve konsiderohet rrezik kombëtar.

V. Konflikti ndërmjet komunistëve dhe nacionalistëve

1. Ata që filluan të parët rezistencën e organizuar në Shqipëri ishin komunistët. Zona e tyre e veprimit ishte fillimisht jugu. Për aq kohë sa Balli Kombëtar nuk kishte formuar çetat në male, nuk ekzistonin përplasje ndërmjet të dy grupeve. Armiqësitë filluan kur çetat nacionaliste u shfaqën në male. Kjo ishte natyrale. Deri atëherë Partia Komuniste ishte lënë të vepronte lirisht. Nacionalistët jo vetëm që nuk e penguan, por e mbështetën rezistencën e tyre kundër armikut. Në fakt, Partia Komuniste kishte qenë e zonja të tërhiqte popullin në anën e vet, se ata nuk ishin komunistë por të etur për aksione. Kur Balli Kombëtar u shfaq në skenë nëpërmjet një programi që i bënte apel popullit shqiptar për rezistencë aktive, për të vepruar në të njëjtën fushë, me të njëjtën popullsi në Shqipëri dhe me shqiptarët, Partia Komuniste e pa atë si rivale të rrezikshme, që do të fuqizohej në kurriz të saj. Ky program përfshinte çlirimin e vendit nga pushtuesi dhe një Shqipëri etnike.
2. Më tej ekzistonin kundërshtime në propogandën e përhapur ndërmjet të dy grupeve, [e cila ishte] aq e hidhur sa që armiku i përbashkët dukej i harruar. Secili, kishte përshtypjen se kishte një betejë për pushtet nga të dy organizatat, të cilat do të zgjasnin dorën për ta kapur. Por, shqiptarët e mendimit të djathtë ishin të mërzhitur nga një situatë të tillë ogurzezë, dhe i kursyen përpjekjet për të arritur mirëkuptimin ndërmjet tyre. Ata gjetën pengesa për një marrëveshje. Nacionalistët shihnin tek Partia Komuniste një organizatë me natyrë thjeshtë ndërkombëtare, të varur nga një qendër e huaj, së cilës nuk mund t'i besonin, ndërsa veprimtaria e saj ishte e detyruar të ndryshonte sipas urdhërave të marrë nga burimet e jashtme.
3. Komunistët, nga ana tjetër, nuk mund të mbështeteshin dhe të bashkëpunonin ngushtësisht me Ballin Kombëtar, sepse politika e tyre e vetme ishte për aksione të forta kundër pushtuesit, pa marrë në konsideratë dëmet e vendit. Komunistët e konsideronin Ballin Kombëtar inaktiv dhe të

prirur për të bërë kompromise me armikun, me qëllim që të ruanin vendin nga dëmet. Bashkëpunimi u bë më i vështirë kur Balli Kombëtar u bë dyshues, duke pretenduar se Partia Komuniste ishte bërë vegël në duart e fqinjëve lakmitarë.

4. Megjithëkëtë, të dyja organizatat kishin të njëjtin qëllim: çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesi. Nëse nuk mund të arrihej një marrëveshje e plotë, u shpresua në arritjen e një marrëveshjeje të pjesëshme. Në të vërtetë, kishte raste kur bandat guerile të të dyja grupeve bashkëpunuan, si në betejën e Vlorës në janar 1943 dhe përreth Tiranë-Kavajës në qershor të këtij viti. Nëse të tillë raste do të ishin theksuar nga të dyja palët dhe nga radiot e Aleatëve, çarja ndofta nuk do të ishte zmadhuar kaq shumë.
5. Në të vërtetë, përpjekja e madhe për bashkëpunim, ndërmjet Ballit Kombëtar dhe Nacionalçlirimtares ndodhi kur Komiteti Qendror i të dy organizatave u takua në Kongresin e Mukjes, (një fshat afër Tiranës), në gusht 1943. Takimi ishte kryesuar nga zoti Thoma Orlogaj- ish kryetar i Gjykatës Supreme, një ish-ministër i Drejtësisë dhe anëtar i Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar. Të dyja organizatat ishin dakord për të unifikuar aksionet dhe për formimin e një Komiteti të Përbashkët, me anëtarë [nga të dy palët], ku Balli Kombëtar do të kishte kryetarin ndërsa Nacionalçlirimtarja sekretarin. Për çështjen e Shqipërisë Etnike kishte mosmarrëveshje; komunistët e kundërshtuan atë dhe firmosja e marrëveshjes u shty.
6. Thuhet se menjëherë pas këtij kongresi, komunistët kishin një takim në Orenjë- një fshat në zonën e Martaneshit, nën drejtimin e dy emisarëve jugosllavë, Miladinoviç dhe Dushanoviç. Pas këtij mitingu, në vend të firmosjes së shpresuar, filloi një betejë aktive ndërmjet nacionalistëve dhe komunistëve. Shqipëria më tej u dënua të kishte një konflikt vëllavrasës, i tillë siç ndodhi në Greqi dhe Jugosllavi.

VI. Veprimtaria e organizatave

1. Gjatë pushtimit italian të dyja grupet, si Balli Kombëtar edhe Nacionalçlirimtarja kishin zhvilluar rezistencë të fortë, e cila vazhdoi edhe kundër gjermanëve. Më vonë bandat e tyre mbetën për disa kohë inaktive kundër gjermanëve, por aktive kundra njera-tjetrës. Bandat guerilje të Ballit Kombëtar nuk kishin më ndonjë arsye të qëndronin më tej në male, veçanërisht pas takimit të përfaqësuesve të tyre në Berat, më 2 janar 1944, ku u vendos të merrnin anën[të bëheshin palë] e gjermanëve dhe të luftonin komunistët.
2. Radhët e Nacionalçlirimtares filluan të shpërbëhen, si rezultat i masave të ashpra kundër tyre dhe mosaprovimit të disa anëtarëve të çarjeve të brendshme. Shumë u kthyen në shtëpitë e tyre, dikush për të mbështetur qeverinë ose për të parë punën e tyre. Por, komunistët e vërtetë dhe disa të

tjerë anëtarë aktivë të Nacionalçlirimtares janë ende në male, duke vazhduar rezistencën me gjermanët.

3. Nga bandat guerilje, më e rëndësishmja prej tyre [për shkak të epërsisë dhe numrit të vet prej dyqind burrash], është banda e Mehmet Shehut, që një muaj më parë po vepron në zonën e Skraparit. Bandat e tjera, me pak ndjekës janë ato të klerikut bektashian Baba Faja, në provincën e Martaneshit; e Myslym Pezës në zonën rreth Tiranës dhe e vëllait të Hysni Kapos, diku në prefekturën e Vlorës. Nuk mund ta imagjini se çfarë vuajtjesh duhet të durojnë ata, ndërsa janë duke u ndjekur këmba këmbës, kur depot e tyre të ushqimit dhe municioneve në Pezë, Orenjë, Martanesh, Zagorie e Skrapar po shkatërrohen dhe po zптоhen nga gjermanët.

VII. Politika e tanishme e qeverisë

1. Tani, personalitet udhëheqës në jetën politike të Shqipërisë është Mehdi Frashëri-kryetar i Këshillit të Regjencës. Kur ushtritë e Musolinit ishin gati për t'u futur në Shqipëri, ishte ai që nxiti mbrojtjen e fortë e të armatosur; ishte sërish ai që foli në radio "Tirana" për botën demokratike, duke dënuar barbarizmat e fashizmit. Kur italianët pushtuan vendin, i pari person që u internua në Itali dhe e mbajtën atje derisa ra Musolini ishte Mehdi Frashëri.
2. Djali i Mehdi Frashërit, juristi Ragip Frashëri, i cili arriti në Stamboll pak kohë më parë me një mision politik, paraqiti privatisht deklaratën e mëposhtme, në lidhje me pranimin e postit [të kryeministrit] nga babai i tij, si dhe për situatën në Shqipëri: "Babait tim iu kërkua nga grupet e ndryshme nacionaliste që të merrte drejtimin e politikës shqiptare. Ai, së bashku me tre patriotë të tjerë u zgjodhën nga Asamblea e Përgjithshme anëtarë të Këshillit të Regjencës. Ai e pranoi këtë detyrë të vështirë për të mirën e vendit. Nëse babai im dhe nacionalistët e tjerë nuk do të kishin marrë pjesë në qeveri, gjermanët do të kishin ndryshuar administratën e Shqipërisë, dhe si rrjedhim, do ta kishin bërë të dëmshme për Shqipërinë. Gjermanët, deri tani nuk e kanë parë të nevojshme [të ndërhyjnë] në punët e brendshme të Shqipërisë. Ata kanë qenë të interesuar të kenë garanci se nuk do ketë sulme ndaj tyre dhe kanë përqëndruar forcat e veta në zona të fortifikuara në bregdet, në portet e Durrësit, Vlorës e Sarandës. Qeveria, e cila e gjeti kaotike gjendjen e Shqipërisë, nën udhëheqjen e babait tim ka ndjekur këtë politikë: Bashkimin e të gjithë elementëve shqiptarë [komunistët përjashtohen], dhe formimin e një ushtrie shqiptare të rekrutuar me 150.000 burra, dhe në veçanti krijimin e një xhandarmërie me 8.000 gjer në 10.000 burra. Këto forca do të përdoren për të sjellë rregullin në shtet, dhe për të mbrojtur vendin në të ardhmen, nga një ndërhyrje e mundshme e fqinjve".

3. Përmasat e ushtrisë, siç e shpalli Ragip Frashëri, duken mjaft të ekzagjeruara, ndërsa ajo do të rekrutohet kryesisht nga Veriu. Jugu është shumë i shkretuar që të kontribuojë me fuqi ushtarake. Por ka një problem të madh: Gjermanët nuk japin armë për shqiptarët. Duket se ata frikësohen, se mos armët do të përdoren kundër tyre në kohën e tërheqjes. Ata premtojnë por nuk i shpërndajnë [armë]. Sa gjatë do të vazhdojnë premtimet e tyre? A kanë qëllim gjermanët të forcojnë qeverinë për t'i dhënë ndihmë ushtarake? Kjo mbetet të shihet.
4. Nga ana tjetër nuk duket se qeveria ka kontrollin e shtetit. Ajo po ruan rregullin në përgjithësi, nëpërmjet mbështetjes së personave me influencë lokale, të tillë si Bazi i Canes në rajonin Krujë-Mat; Fiqri Dine, si drejtues i fiseve të Dibrës në prefekturën me të njëjtën emër; Princ Gjon Marka Gjoni në distriktin e Mirditës; kleri katolik në prefekturën e Shkodrës dhe Shefqet Vërlaci në provincën e Elbasanit. Në pjesën jugore, ku influenza personale nuk ekziston, disa distrikte janë nën kontrollin e qeverisë dhe të tjerë nën atë të bandave.

VIII. Publikimet

1. Gazeta zyrtare e qeverisë “Bashkimi i Kombit” (The Union of the Nation), që botohet përditë, ka si botues Akile Tasin, që ka studiuar në Shtetet e Bashkuara, dhe ka jetuar atje për një kohë të gjatë. Ajo duket se mban disi një qëndrim të pavarur ndaj interesave të Shqipërisë dhe botimeve të Aleatëve, gjithashtu edhe ndaj komunikatave të gjermanëve. Më 24 shkurt 1944, ajo botoi një artikull lavdërues për Shkollën Teknike në Tiranë, të krijuar nga amerikanët më 1921. (Sipas Ragip Frashërit, Lef Nosi, një nga anëtarët e Këshillit të Regjencës është i interesuar për restaurimin e shkollës amerikane në Kavajë dhe të Bibliotekës Karnavon.)
2. Një tjetër gazetë pro qeveritare është “Arbënia” (Albania), e botuar nga Nebil Çika. Ekzistojnë gjithashtu edhe dy gazeta të tjera të botuara pa lejen e qeverisë, por të toleruara prej saj: “Atdheu (Fatherland), një publikim pro Zogut, dhe “Mbrojtja Kombëtare” (The National Defense), një gazetë nacionaliste dhe antikomuniste. Dy gazetat e fundit, botohen jo rregullisht, dhe nuk zbulohen emrat e botuesve. Ka dy botime të fshehta: “Bashkimi” (The Union), organ i Nacionalçlirimtares dhe “Zëri i Popullit” (The Voice of the People”), organ i Partisë Komuniste, e cila ndonëse brenda NÇL, qëndron si një grup i ndarë.

IX. Të dërguarit amerikanë në Shqipëri

1. Sipas Ragip Frashërit, në dhjetor 1943, një oficer dhe një mësues amerikan, të shoqëruar nga një shqiptar, zbarkuan afër portit të Vlorës. Ata kërkuar të takoheshin me Mehdi Frashërin. Regjenti ishte informuar, por ai nuk mund ta ekspozonte veten në bisedime me këta burra nga frika e

gjermanëve. Në vend të Regjentit, Skënder Muço, një avokat në Tiranë dhe një ish komandant i një bande të Ballit Kombëtar në prefekturën e Vlorës, pati kontakte me amerikanët. Ai u ndje i kënaqur nga bashkëbisedimi me ta dhe tha se amerikanët i kishin këshilluar nacionalistët që t'i jepnin mbështetje qeverisë, por i paralajmëruan që qeveria të mos shkonte shumë larg në bashkëpunimin me gjermanët.

X. Çështja e kufijve

1. Ky është një nga shqetësimet e mëdha të popullit shqiptar. Gjermanët e kanë shfrytëzuar atë me aftësi, duke e përshkruar si rrezik të pashmangshëm për vendin, pas tërheqjes së forcave të tyre. Ata i kanë shtyrë shqiptarët të mendojnë për të ardhmen e vendit dhe armatosjen e tyre, me qëllim që të mbrohen nga ndërhyrjet e fqinjëve, e cila do të rezultonte në një kasapanë për popullin. Çështja mund të ndahet në dy pjesë: e kufijve jugorë dhe e Kosovës.
 - a. *Problemi i kufijve jugorë*
 1. Greqia ka paraqitur pretendimet për pjesën jugore të Shqipërisë, (prefekturën e Korçës dhe Gjirokastrës), disa herë para Konferencës së Paqes të vitit 1919. Një komision ndërkombëtar u ngrit për të shqyrtuar çështjen në terren; studimin e popullsisë në të dyja aspektet, etnik e gjuhësor dhe për të rregulluar kufijtë. Kufijtë e sotëm janë fiksuar gjatë Luftës Italo-Greke, megjithatë, Greqia zbuloi sërish qëllimet e saj për të aneksuar Shqipërinë e Jugut, ose Epirin e Veriut si e quajnë grekët dhe është shtuar frika e popullit shqiptar, i cili gjatë luftës me italianët e ndihmoi Greqinë dhe tregoi kështu dëshirën e sinqertë për bashkëpunim të ngushtë.
 2. Kur ushtritë e Musolinit sulmuan Greqinë, Legata Shqiptare në Turqi i propozoi menjëherë qeverisë greke, përmes përfaqësuesit të saj në Ankara, zotit Raphael, formimin e një legjioni me flamur shqiptar, të komanduar nga oficerë shqiptarë, i cili do të jetë nën urdhërat e Shtabit të Lartë grek. Ky legjion do të luftonte hap pas hapi me ushtrinë greke për çlirimin e atdheut të vet. Qeveria e Metaksait e pranoi me dëshirë këtë propozim, dhe shqiptarët nxitën konsullatën e tyre në Stamboll që ta regjistronte. Megjithëkëtë, sapo grekët morën vesh për përparimin e ushtrisë së tyre brenda territorit shqiptar, ata harruan gjithçka ishte arritur me marrëveshjen e mësipërme.
 3. Gjatë luftës së italianëve me Greqinë, oficerët shqiptarë me ushtarët e tyre (pastaj ushtria shqiptare u përfshi në ushtrinë italiane) kaloi nga ana e grekëve, dhe luftoi me grekët kundër trupave pushtuese. Të tjerët dezertuan. Në fakt, disa gazeta italiane ia faturuan humbjen në malet e Shqipërisë tradhëtisë së një pjese të shqiptarëve. Komanda italiane madje e

burgosi [izoloi] pjesën e mbetur të ushtrisë shqiptare në periudhën e mbetur të luftës në qytetin e Shijakut në Shqipërinë Qendrore.

4. Kur grekët hynë në qytetet shqiptare ata u mirëpritën nga popullsia si çlirimtarë. Kjo e fundit shpresonte të shihnte të ngritur sërish flamurin shqiptar dhe rikthimin e administratës shqiptare. Por e kuptuan shpejt se shpresat e tyre kishin dështuar dhe sundimi grek ishte vendosur në vend. Shtypi grek madje foli edhe për “Korçën Helene”. Shqiptarët e ndjenë se ajo që kishte ndodhur në të vërtetë ishte vetëm një ndryshim i padronëve.
 5. Një grup nacionalist me influencë që ishte mbledhur në Tiranë gjatë luftës, i propozoi komandantit të ushtrisë së nëntë greke të rajonit të Gjirokastrës, gjeneralit Tselakoglon, një revoltë në bashkëpunim me grekët në të gjithë Shqipërinë, për të hedhur ushtrinë e Musolinit në det. Nëse do të kishte sukses, Greqia duhej të njihte integritetin territorial dhe pavarësinë e Shqipërisë. Gjenerali grek u përgjigj se ai nuk kishte kompetencë për një çështje të tillë, dhe se ai do t’ia përcillte propozimin qeverisë së tij në Athinë. Përgjigja u prit gjatë, por ajo nuk mbriti kurrë.
 6. Pretendimet greke nuk do t’i dekurajonin shqiptarët, të cilët nuk po shihnin që të mbështeteshin as nga Fuqitë e Mëdha Aleate. Shqiptarët e pritën me kënaqësi të madhe deklaratën e fortë, të bërë nga Sekretari i Shtetit Cordell Hull, për pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Kjo deklaratë u ndoq nga ajo e Molotovit.
 7. Kjo kënaqësi nuk do të zgjaste shumë. Tetë ditë më vonë, qeveria britanike bëri një deklaratë e cila shkaktoi një frikë të madhe, sepse ajo shpallte se “çështja e kufijve të shtetit shqiptar pas luftës është një problem, i cili do të merret në shqyrtim në Konferencën e Paqes”.
 8. Kjo frikë duket se u përlligj me deklaratën e menjëherëshme të kryeministrit grek Tsouderos, në të cilën ai foli hapur për synimet greke për Shqipërinë e Jugut. Që atë here, të dyja, qeveria greke në emigracion, me përfaqësuesit e saj, zoti Diamantopulos në Washington dhe zoti Agnides në Londër, nuk e kanë pushuar propogandën për “këto pretendime mashtruese”. Rezultati [i kësaj politike] ishte pengimi i bashkëpunimit ndërmjet grekëve dhe shqiptarëve, dhe më vonë shtimi i bindjes, se [shqiptarët] duhet të mbronin vendin e tyre nga ndonjë sulm i ardhshëm grek.
- b. Çështja e Kosovës*
1. Kosova është një rajon shqiptar, i cili ishte pjesë e shtetit jugosllav përpara luftës me Gjermaninë. Ajo ka një popullsi prej 850.000 shqiptarësh sipas statistikave shqiptare. Sipas statistikave jugosllave ajo ka 450.000 shqiptarë, ndërsa sipas atyre të Lidhjes së Kombeve ajo ka 600.000 shqiptarë. Për popullsinë shqiptare sundimi jugosllav ka qenë shtypës.

- Fermat shqiptare u konfiskuan nga shteti [jugosllav] dhe iu dhanë kolonistëve serbë e malazezë.
2. Pas rënies së fundit të Jugosllavisë, shumë nga këta kolonistë e lanë vendin dhe të tjerët u dëbuan. Askush nuk e di me ekzaktësi se sa jugosllavë kanë mbetur, por nuk ka dyshim, se ende shqiptarët përbëjnë shumicën dërmuese të popullsisë. Sipas statistikave më të fundit shqiptare, popullsia shqiptare e Kosovës llogaritet tek 90%.
 3. Fuqitë e Boshtit, të cilat i dhanë Kosovës lirinë e saj si pjesë e shtetit shqiptar, janë përpjekur të bëjnë maksimumin për të nxitur armiqësitë ndërmjet popullsisë vendase shqiptare dhe banorëve të tjerë. Kanë ndodhur një sërë luftimesh ndërmjet çetnikëve dhe kosovarëve. Në maj 1943 një kasapanë ndodhi në Bihor, afër Malit të Zi; 5400 shqiptarë, burra, gra dhe fëmijë u masakruan nga çetnikët jugosllavë dhe pasuesit e Mihajllloviçit. Vetëm dy muaj më pas, më 17 shkurt 1944, trupat e rregullta serbe dhe çetnike pushtuan provincën shqiptare të Novi-Pazarit dhe plaçkitën 15 fshatra. Kosovarët u ngritën menjëherë dhe në betejën që pasoi, pati humbje nga të dy anët. Beteja ishte në vazhdim e sipër më 5 mars 1944. Të tilla sulme dhe beteja që po ndodhin, me siguri do të shpeshohen në kohën e çlirimit.
 4. Kosovarët, që nga natyra janë luftëtarë, kanë formuar tashmë një Komitet për mbrojtjen e Kosovës, të quajtur “Lidhja e II e Prizrenit”, të drejtuar nga Bedri Peja. Kjo të kujton Lidhjen e I të Prizrenit (qytet në krahinën e Kosovës) e cila u formua më 1878, me qëllim që ti rezistonte cënimit të territoreve shqiptare dhe ruajtjes së themeleve të pavarësisë shqiptare.

XI. Zgjidhja e problemit

1. Pretendimet erritorial të fqinjëve të Shqipërisë na çojnë tek çështja shumë serioze e të ardhmes: Cilat ushtri do të pushtojnë zonat e pretenduara, kur këto të çlirohen nga gjermanët? Pa dyshim, rregullimi më i mirë do të ishte që forcat anglo-amerikane ti okuponin ato, dhe më vonë, të mbahej një plebishit sipas Kartës së Atlantikut. Kjo mënyrë do të kursente shumë gjak dhe do të shmangte shqetësimet e mëdha. Është e dëshirueshme që për të shmangur një fatkeqsi të tillë, të nxitet shoqata Anglo-Shqiptare në Londër, që në rezolutën e saj të përfshijë një nen, ku të thuhet se ajo duhet të nxisë Ministrinë e Jashtme Britanike “që territoret shqiptare të okupohen pa pretekst dhe në kohë, para ndërhyrjes së ndonjerit prej fqinjëve të saj”. Ngjarjet e fundit tërheqin vëmendjen për domosdoshmërinë e një zbarkimi aleat në zonat e kontestuara.

XII. Besimi i shqiptarëve në demokracinë amerikane

1. Shqiptarët gjatë kohëve kanë treguar se ata e urrejnë zgjedhën e huaj dhe se ata janë dashnorë të zjarrtë të lirisë. Megjithëse me forca të pabarabarta,

ata luftuan me trimëri kundër pushtuesve fashistë gjatë pesë vjetëve. Por ata patën një kënaqësi të vërtetë nga deklarata Cordell Hull. Shqiptarët nuk dyshuan kurrë se Republika e Madhe përgjatë Atlantikut, do të ishte e para në njohjen e përpjekjeve të tyre, dhe do të jepte mbështetjen më të madhe për kauzën e tyre të drejtë. Ata besojnë se amerikanët do t'u qëndrojnë me besnikëri parimeve njerëzore që kanë shpallur.

2. Shqiptarët nuk mund të harrojnë se ishte presidenti Wilson ai, i cili mbrojti me shumë zell kauzën e tyre në Konferencën e Paqes. Ata e kuptojnë, se politikanët amerikanë nuk janë të lidhur aq ngushtësisht me politikanët europianë, dhe se opinioni amerikan synon të jetë i paanshëm dhe i drejtë, dhe [kjo] është tamam ajo që duan shqiptarët. Nëse sot gjatë pushtimit gjerman, shqiptarët nuk mund të kontribuojnë kaq aktivisht për kauzën e Demokracive, sikundër ata bënë gjatë pushtimit italian, është e sigurt se në të ardhmen ata nuk do t'i kursejnë sakrificat më të mëdha për këtë kauzë, e cila është kaq e dashur për ta.

Përktheu dhe përgatiti për botim
Hamit KABA